



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-132

Prishtinë, më 11 nëntor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 NËNTOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sreten Ivanoviq dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Çështjet aktuale

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me pikat e papërfunduara nga seanca e mëparshme, si dhe me parashtresat e tjera, që i kishin plotësuar kushtet për t'u proceduar për shqyrtim në seancë plenare.

Kryetari, me qëllim të tejkalimit të situatës së krijuar në Kuvend lidhur me procedimin e raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së dhe të formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së, të pezullohen përkohësisht, përkatësisht të hiqet nga rendi i ditës i seancës plenare të radhës.

Në lidhje me propozimin e kryetarit diskutuan: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, nënkryetar të Kuvendit; Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të GP të VV-së; Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së; dhe Myzejene Selmani, në emër të G/P të KKR-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara dhe shqyrtimit të përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 14 nëntor 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet normative,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012,
11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës,
13. Emërimi i anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
14. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
15. Emërimi i 2 (dy) anëtarëve të Bordit të RTK-së.

2. Kërkesa për lejimin e transferimit të mjeteve buxhetore shtesë për RTK-në

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën e drejtorit të përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës për transferimin e mjeteve buxhetore për RTK-në, në shumën prej 1 000 000 euro, të ndara sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Formimi i Komisionit ad hoc për intervistimin e kandidatëve për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 14 nëntor 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për intervistimin e kandidatëve për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

- Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtarë; GP i AAK-së, 1 anëtar, GP i KKR-së, 1 anëtar; GP i SLS/GP ZB, 1 anëtar; dhe GP "6+", 1 anëtar.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit të delegacionit të Kuvendit në Parlamentin Evropian

Me propozimin e kryetarit, Kryesia vendosi që kërkesën e lartshënuar t'ia kthejë parashtresit, me qëllim të rishikimit të përbërjes së delegacionit për ta lejuar në mbledhjen e radhës.

5. Procedimi i Projektligjit për shërbimin gjeologjik

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e këtij projektligji, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për shërbimin gjeologjik, të hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-në të këtij projektligji në afat prej një muaji nga dita e pranimit.

6. Procedimi i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e këtij projektligji, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- Projektligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

- Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor që ta shqyrtojë Projektligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin para shqyrtimit të parë.

7. Kërkesa për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 14 nëntor 2013, t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

- Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i KKR-së, 1 anëtar; GP i SLS/GP ZB, 1 anëtar; dhe GP “6+”, 1 anëtar.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale